



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në bazë të neneve 12.2 shkronja d, 14.1 dhe 17 shkronja f të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 5 parag. 3.1 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit nr. 03/L-025 dhe neneve 15.2 shkronja d, 17.1 dhe 19 shkronja f të Statutit të Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 06 dhjetor 2016, miratoi,

VENDIM

PËR DESTINIMIN - CAKTIMIN E PALUAJTSHMËRIVE PËR NDËRTIMIN E IMPIANTIT PËR TRAJTIM BIOLOGJIK TË UJËRAVE TË ZEZA NË FSHATIN ORLLAN KOMUNA E PODUJEVËS

Neni 1

Për ndërtimin e Impiantit për Trajtimin Biologjik të Ujërave të Zeza “ Rotating Discs Porcess “ dhe rrjetit të kanalizimit në fshatin Orllan, Komuna e Podujevës, destinohen – caktohen paluajtshmëritë në pronësi të Komunës të evidentuara në Njësitë kadastrale:

- P-71712058-01616-0, kultura bujqësore-Kullosë, kl. 3, në sipërfaqe 13814 m², vendi i quajtur Golesh-Golesh, Zona Kadastrale Orllan, në pronësi të Komunës, dhe
- P-71712058-01617-0, kultura tokë pyjore, kl. 5, në sipërfaqe 15418 m², vendi i quajtur Golesh-Golesh, Zona Kadastrale Orllan.

Neni 2

Projekti, sipas parallogarisë në vlerë 500,000.00 €-600,000.00 €, është në pajtim me Planin Zhvillimor të Komunës i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës nr. 01-006-17246 të datës 2 mars 2016, dhe në funksion të evitimit të derdhjes së ujërave të zeza në liqenin e Batllavës prej të cilit komuna e Podujevës, e Prishtinës dhe disa komuna të tjera furnizohen me ujë të pijes, realizohet nga donacionet e Qeverisë së Zvicrës në implementim nga Konzorciumi DORSCH/CDI dhe mbështetje të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Komunës së Podujevës dhe KUR “ Prishtina “ sh.a.

Neni 3

Ky vendim ju paraprinë procedurave për marrjen e lejes mjedisore, lejes së ndërtimit dhe dokumentacionit të nevojshëm konform dispozitave ligjore dhe nënligjore për realizimin e projektit përkatës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-006-88066
Podujevë,
06 dhjetor 2016



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PODUJEVË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Orllan

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m2
P-71712058-01616-0	Pracelë / Parcela / Parcel	13814,0
P-71712058-01617-0	Pracelë / Parcela / Parcel	15418,0



Shkalla/Razmera/Scale: 1:3034

08-095/89744

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 17.11.2016

Koha/ Vreme/ Time: 02:07:33

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

[Handwritten signature]

Aprovim/Priliceno/Approved: MCO PODUJEVË director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:



[Handwritten signature]